



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



| | | | |
|--|-------------------------------|------------------------------|-------------------------------|
| Pranimi / Dorezimi Prilaz / Predaja Receipt / Delivery | 05.12.23 | viti god Year | |
| Organ / Rreza Organ / Jedinstvo Org / Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtesa Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKOMSHAK | 7243/2023 | | 114 |



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1254/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi, dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1254/2023 të datës 05.10.2023 të parashtruar nga ankuesit: të cilët me autorizim i përfaqëson avokati

kundër Vendimit me numër Nr.01-030/01-118544/23 të datës 18.08.2023 të Kryetarit të Komunës së Prizrenit, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 04.12.2023, mori këtë.

V E N D I M

- I. Aprovohet si pabazuar ankesa A.nr.1254/2023 e datës 05.10.2023 e parashtruar nga ankuesit ashtu që Shfuqizohet Vendimi me Nr.01-030/01-118544/23 i datës 18.08.2023 i Kryetarit të Komunës së Prizrenit, dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të i njëjti organ.
- II. Obligohet Kryetari i Komunës së Prizrenit që të rishqyrtoj vendimin brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesit (në tekstin në vijim referuar si ankuesit), me datë 05.10.2023 kanë parashtruar ankesë me numër protokolli 6402/2023 të regjistruar nën shenjën A.nr.1254/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin



Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër Nr.01-30/01-118544/23 të datës 18.08.2023 të Kryetarit të Komunës së Prizrenit, për shkak të shkëljes se dispozitave të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 06.10.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Prizrenit, ndërsa me datë 17.10.2023, nga kjo e fundit ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën A.nr.6402/2023 të datës 05.10.2023; Vendimin me numër protokoll Nr.01-030/01-118544/23 të datës 18.08.2023 të Kryetarit të Komunës së Prizrenit; Akt Emërimit me numër protokoll A.E.Nr.01-112-157988/2021 të datës 07.10.2021; Akt Emërimit me numër protokoll A.E.Nr.01-112-158191/2021 të datës 08.10.2021; Procedimi i sistemit së pagave i datës 01.08.2018; Fletë dorëzim i datës 09.10.2018; Planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve nga Zyra Kombëtare e Auditimit; Autorizimin e datës 19.09.2023; Raportin e datës 21.03.2023, Rekomandimin me numër protokoll Nr.01-052/09-39022/23; Vendimi me numër protokoll Nr.01-06-167669 Të datës 29.11.2022; Raportin e auditimit për pasqyra financiarë vjetor të Komunës së Prizrenit; Raportin e Monitorimit për vitin 2020; Lista e pagave nga data 01.02.2023, deri me datën 26.02.2023; Listën e pagave nga data 01.12.2018 deri me datën 31.12.2018; Listën e pagave nga data 01.01.2019 deri me datën 31.01.2019; Listën e pagave nga data 01.02.2019 deri me datën 28.02.2023; Vendimin Nr.34/2022 të datës 30.03.2023 të Këshillit; Vendimin VKM/2023 të datës 21.03.2023 të Këshillit; Raportin e Monitorimit për vitin 2021 për Komunën e Prizrenit; Raportin e Monitorimit për vitin 2020 për Komunën e Prizrenit; Akt Emërimit e datës 04.01.2012; Përgjigjen në ankesë me numër protokoll 1254/2023 të datës 17.10.2023.

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e bashkangjitura të lëndës ka konstatuar se ankesa A.nr.1254/2023 e datës 05.10.2023 është e bazuar dhe se lënda duhet të kthehet në *rishqyrtim dhe rivendosije* të organi i njëjtë, *sepse*:

Ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshill pretendojnë se Vendimit me Nr.01-30/01-118544/23 i datës 18.08.2023 i Kryetarit të Komunës së Prizrenit është nxjerr përmes shkëljes se dispozitave të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase sipas tyre Kryetari i Komunës së Prizrenit me rastin e nxjerrjes së aktit të kontestuar ka vepruar jashtë kompetencës dhe se i njëjti vendim është diskriminues për faktin se janë trajtuar në mënyrë jo të barabartë me nëpunësit tjerë pasi që ndryshimi apo harmonizimi i koeficienteve është bërë në pajtueshmëri me Thesarin e Kosovës dhe Departamentin për Administrimin e Shërbimit Civil.

Kolegji i Këshillit, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore analizoi aktin e goditur me ankesë, gjegjësisht Vendimit me Nr.01-030/01-118544/23 të datës 18.08.2023 të Kryetarit të Komunës së Prizrenit, nga analizimi i të cilit rezulton se janë shfuqizuar të gjitha akt emërimet dhe aktet e tjera lidhur me marrëdhënies punës të lëshuara në tetor të vitit 2021 sipas ndryshimit të listës së

pagave në janar të vitit 2019, si dhe është obliguar Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore për nxjerrjen e akt emërimeve në bazë të rekomandimit që është nxjerr nga të gjeturat e grupit punues.

Kolegji i Këshillat në kontekst të vlerësimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore po ashtu analizoi dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 47 paragrafi 1, ku përcaktohet se: "1. Akti administrativ i shkruar përmban: 1.1. pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes; 1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit. 1.3. pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin); 1.4. pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike)...", dhe si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, konstatoi se pjesa urdhëruese e aktit të kontestuar apo dispozitivi është i paqartë dhe rezulton të jetë vështirë i zbatueshëm ngase i njëjti nuk sqaron se cilat akte apo akt emërime janë shfuqizuar me këtë vendim, duke specifikuar kështu në mënyrë taksative emrin e zyrtarit si dhe numrin dhe datën e aktit të emërimit i cili sipas organit të punësimit pretendohet se është i paligjshëm. Po ashtu, pjesa e tretë e aktit të kontestuar apo arsyetimi duhet të përmbajë një shpjegim të situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi, shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave, bazën ligjore të vendimit dhe arsytën pse është e zbatueshme në rastin konkret, duke ju referuar kështu secilit rast veç e veç, ngase trajtimi në mënyrë të përgjithshme duke theksuar që: "Shfuqizohen të gjitha akt emërimet dhe aktet e tjera lidhur me marrëdhënies punës të lëshuara në tetor të vitit 2021 sipas ndryshimit të listës së pagave në janar të vitit 2019 nuk i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ dhe si i tillë është i paqarte dhe i pakuptueshëm dhe për rrjedhojë në kundërshtim me nenin 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Si rrjedhojë, Kolegji i Këshillit konstaton se Vendimi me Nr.01-030/01-118544/23 i datës 18.08.2023 është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ngase është nxjerr si rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative dhe në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ, kështu që si i tillë ky akt administrativ për shkak të paligjshmërisë së pasojave të metave procedurale të theksuara sikurse në arsyetim të këtij vendimi, pamundëson vlerësimin e ligjshmërisë së pretendimeve ankimore për vendosje meritore, andaj Kolegji i Këshillit vendosi që lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të i njëjti organ me detyrimin që ky i fundit të rishqyrtoj çështjen lidhur me rastet e ngritura nga ankuesit, gjithnjë duke pasur parasysh pikëpamjet juridike të këtij vendimi në kuptim të eliminimit të shkeljeve të konstatuara dhe vetëm pas eliminimit të këtyre shkeljeve të nxjerrë vendim në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe në mbështetje të fakteve të vërtetuara në mënyrë të plotë dhe të drejtë, respektivisht dispozitivi dhe arsyetimi i aktit administrativ të jenë në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.



Andaj, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.1254/2023

Flakron Gashi

Procesmbajtës

Jeton Koca

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesve Avokatit,
- Kryetarit të Komunës së Prizrenit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.